

KOZETA HYSO

MËSIMI I KUPTIMIT TË FJALËS NGA KONTEKSTI DHE ROLI I KUJTESËS FONOLOGJIKE

Abstrakt

Mësimi i kuptimit të fjalës nga konteksti është një temë e rrahur jo pak në fushën e leksikut. Lidhja e fjalës me tekstin është i një rëndësie të veçantë, sepse nëpërmjet fjalës, jo vetëm kuptojmë tekstin, por mësojmë edhe një gjuhë të huaj.

Pra, duke mësuar kuptimin e një numri të caktuar të fjalëve, ne jemi në gjendje të kuptojmë tekstin, ku ato bëjnë pjesë dhe të shtojmë fjalorin tonë aktiv dhe pasiv. Ka një lidhje të ngushtë midis njohjes së kuptimit të fjalëve dhe mënyrës se si mbahen mend ato, gjithmonë e lidhur kjo me kontekstin, por edhe me tingullin dhe shqiptimin e vete fjalës.

Në këtë shkrim është trajtuar fakti se si ndikon konteksti në njohjen e kuptimit të fjalëve, apo si ndikon kujtesa e formës fonologjike të fjalës, për zhvillimin e aftësive tona në aspektin e përvetësimit të gjuhëve të huaja, bazuar në raportin që ekziston midis kujtesës së shpejtë fonetike dhe gjuhës.

Fjalë kyçe: Fjala, konteksti, kujtesa fonologjike, kuptueshmëria e teksteve.

Mësimi i kuptimit të fjalës nga konteksti

Një nga lidhjet më të vjetra që ekziston në fushën e studimit të gjuhëve të huaja është pikërisht lidhja e fjalorit me tekstin, pasi njohja e fjalëve është element bazë në përvetësimin e një teksti, si dhe faktor i rëndësishëm, në përcaktimin e kuptueshmërisë së tekstit, në të gjitha nivelet e studimit të gjuhës së huaj.

Koncepti mbi kuptueshmërinë e tekstit është i ndryshëm nga ai i njohjes dhe të mbajturit mend të kuptimit të fjalëve. Është e kuptueshme tashmë, që, nëse nuk do të kemi një sasi të mjaftueshme fjalësh të njohura, do të jetë e vështirë për të kuptuar, apo për t'u futur thellë në përmbajtjen e tekstit. Ekspertët e leksikut pohojnë se kuptueshmëria e tekstit, varet direkt nga njohja e kësaj sasive fjalësh. Kështu ata kanë arritur në përfundimin se kushdo që studion një gjuhë të huaj, mund të hyjë në përmbajtjen e një teksti vetëm nëse njeh 90% të fjalëve të tij. Duke njohur midis 90% dhe 95% të fjalëve të tekstit, çdokush e ka më të lehtë që të marrë idenë kryesore nga leximi i tij, të gjejë më lehtë kuptimin e fjalëve të panjohura, pra të pasurojë fondin e përgjithshëm të njohurive të tij mbi fjalët. Ata që nuk njohin, të paktën 90% të fjalëve, jo vetëm që do kenë vështirësi në kuptueshmërinë e tekstit, por edhe do të

humbasin mundësinë për të mësuar fjalë të reja (Hirsch, 2003)¹. Ne mund t'i përdorim aftësitë tona, për të marrë njohuritë e dobishme rreth kuptimit të fjalëve të reja, nga konteksti, nga shpjegimi, nga fjalori, apo direkt nga ato. Pra një faktor që mund të ndikojë në aftësinë e të mësuarit të kuptimit të fjalëve, si u tha dhe më sipër, është sasia e fjalëve që njohim që më parë.

Shefelbine (1990)² në studimin e tij doli në përfundimin, se nxënësit me nivel gjuhësor të ulët në përvetësimin e fjalëve nga konteksti, dështojnë shpesh në kuptueshmërinë e tekstit, pasi ata nuk i dinë shumë fjalë që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Në këtë rast duke mos njohur pjesën më të madhe të fjalëve, ata e kanë të pamundur të japin një shpjegim të qartë të kuptueshmërisë së tekstit.

Një tjetër faktor i rëndësishëm për rritjen e këtyre aftësive, është të kujtuarit e formës fonologjike të fjalës, nëse ajo është e regjistruar në kujtesë. Kjo mund të bëhet përpara se të fillojmë mbledhjen e të dhënave, që kanë të bëjnë me përkufizimin e fjalës, mbasi tingulli fonetik i fjalës mund të zgjojë kujtesën për të parashikuar përkufizimin e saktë, të mundshëm të fjalës, Gathercole & Baddeley, 1989, 1990)³. Disa studime sugjerojnë që ky efekt duhet të jetë shumë i fortë në këndvështrimin e përvetësimit të gjuhës së dytë (Gathercole, Willis, Emslie & Baddeley, 1992)⁴. Vështirësi paraqesin fjalët e gjuhës së huaj, që nga ndërtimi i tyre fonologjik, ndryshojnë nga ato të gjuhës amtare (Papagno, Valentine & Baddeley, 1991)⁵.

Ka një marrëdhënie të dukshme midis kujtesës së shpejtë fonologjike dhe gjuhës amtare, e cila shprehet jo rrallë në moshat e reja. Por aftësia për të njohur tekstin varet dhe nga përvoja e hershme me gjuhën e dytë të huaj. Është më e lehtë të mësosh një përkufizim për një koncept ekzistues, sesa të mësosh një koncept komplet të ri, nën një përkufizim të ri. (Graves, 1986; Nagy, Anderson & Herman, 1987)⁶.

¹ E. D. Hirsch (2003). *Reading comprehension requires knowledge – of words and the world: Scientific insights into the fourth-grade slump and the nation's stagnant comprehension scores*. American Educator, Spring, 2003. American Federation of Teachers.

² J. Shefelbine (1990). *Student factors related to variability in learning word meanings from context*. Journal of Reading Behavior, 22, 71-97.

³ S. Gathercole & A. Baddeley (1989). *Evaluation of the role of phonological STM in the development of vocabulary in children: A longitudinal study*. Journal of Memory and Language, 28, 200-213.

⁴ S. Gathercole, C. Willis, H. Emslie & A. Baddeley (1992). *Phonological memory and vocabulary development during the early school years: A longitudinal study*. Developmental Psychology, 28, 887-898.

⁵ C. Papagno, T. Valentine, & A. Baddeley (1991). *Phonological short-term memory and foreign-language vocabulary learning*. Journal of Memory and Language, 30, 331-347.

⁶ M. F. Graves (1986). *Vocabulary learning and instruction*. In E. Z. Rothkopf & L. C. Ehri (Eds.), *Review of research in education* (Vol. 13, pp. 49-89). Washington, DC: American Educational Research Association.

Kujtesa fonologjike dhe njohuritë ekzistuese për fjalët, mund të jenë faktor i rëndësishëm në aftësinë e njohjes së kuptimit të tyre, por ndonjëherë ato na ndihmojnë pak, na kthejnë mbrapsht, duke na forcuar idenë, që puna me fjalorin duhet filluar herët.

Faktorët metalinguistikë dhe metakonjitivë japin një kontribut shumë të mirë në përvetësimin e njohurive mbi kuptimin e fjalëve të reja.

Marrja e njohurive bazë mbi kuptimin e fjalëve është gjithashtu edhe rrjedhojë e njohjes së botës që na rrethon. Studimet kanë treguar se këto njohuri mbi botën në tërësi janë faktorë të rëndësishëm, për të kuptuar atë çfarë lexojmë (Anderson & Pearson, 1984)⁷. Ndodh që të kuptojmë të gjitha fjalët e tekstit dhe ende të mos i japim kuptim real përmbajtjes së tij, nëse nuk kemi njohuri për çështjet që diskutohen aty. Kur kemi njohuri mbi to, sigurisht që njohim edhe fjalorin përkatës të tyre.

Kuptimi i fjalëve nuk është i palidhur me informacionin përkatës, por është pjesë e strukturës së të tërës (Stahl, 1999)⁸. Kuptueshmëria e tekstit dhe fjalori mund të përvetësohen më mirë, duke bërë njëkohësisht leximin, dëgjimin e të njëjtës çështje dhe pastaj diskutimin e fakteve dhe mendimeve për të. Këto veprime, përmirësojnë leximin, zhvillojnë fjalorin, si dhe aftësinë e të shkruarit (Hirsch, 2003). Lexuesit e mirë shpesh përdorin disa referenca të konteksti, për të hyrë në kuptueshmërinë e tekstit, duke e përdorur atë për njohjen e kuptimit të fjalëve të panjohura. Të gjithë ata që nuk janë shumë aktivë, duhen të ndjekin rrugën e dhënies së përkufizimit të saktë të fjalëve të reja, si pjesë e strategjisë që duhet përdorur, kur ndeshen me fjalë që nuk ja u dinë kuptimin.

Mjetet që na ndihmojnë të njohim kuptimin e fjalës

Kur ndeshemi me fjalë të panjohura, është e rekomandueshme, që ti referohemi, njohurive mbi bazën e fjalës ose më mirë të themi, të rrënjës së saj, duke marrë parsysh më vonë parashtesat dhe prapashtesat, që na ndihmojnë për gjetjen e kuptimit të saj. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur mësojmë nëpërmjet leximit, sepse masa e kuptimit të tekstit në përgjithësi, varet edhe nga sasia e fjalëve që përmban ai dhe veçanërisht kur ato rrjedhin nga e njëjta familje. P.sh. njohja e rrënjës së fjalës greke “bio” që do të thotë jetë, apo organizëm i gjallë, na ndihmon të njohim kuptimin e fjalëve ku ajo bën pjesë si: biologji, biosfere, degradim biologjik, biokimi, etj.

Analiza strukturore e fjalës, si mjet në ndihmë të njohjes së shpejtë të kuptimit të saj, detyrimisht duhet filluar nga njësia më e vogël kuptimore, që

⁷ R.C. Anderson & P. D. Pearson (1984). *A schema-theoretic view of basic processes in reading*. In P.D. Pearson, R. Barr, M. L. Kamil, & P. Mosenthal (Eds.), *Handbook of reading research*. New York: Longman.

⁷ E. D. Hirsch (2003). *Reading comprehension requires knowledge*.

⁸ S. A. Stahl (1999). *Vocabulary development*. Newton Upper Falls, MA: Brookline Books.

është morfema. Një morfemë e lirë apo rrënja e fjalës, mund të jetë e vetme p.sh. cut (pres) apo e përbërë nga dy ose më shumë morfema, të cilat mund të kombinohen në formën e një fjale të përbërë. P.sh., (airplane) aeroplan (Blachowicz & Fisher, 2004)⁹.

Nga ana tjetër, analiza strukturore e shpejtë dhe automatike e fjalëve, kur fillojmë të mësojmë një gjuhë të huaj, është vendimtare, jo vetëm për zhvillimin e aftësisë dhe rrjedhshmërisë së leximit, por edhe të përvetësimit të shqiptimit. Përqendrimi i analizës së fjalëve, kur i referohemi fjalorit, mbështetet te pjesa më kuptimore dhe ndihmon në kuptimin në tërësi të tyre.

Thjesht, të shikosh shpjegimin e zakonshëm të fjalëve të një fjalor, nuk është asnjëherë e mjaftueshme. Për tu njohur me kuptimin e saktë të fjalës në një kontekst, duhet t'u referohemi edhe situatave, ku ajo mund të përdoret, si dhe sinonimeve dhe antonimeve të saj, gjithnjë kur është e mundur. Na ndihmon gjithashtu edhe krijimi i fjalive me fjalë të veçanta, nëpërmjet të cilave, realisht tregohet kuptimi i saj.

Ndonjëherë është e nevojshme të fusim në fjali më shumë se një fjalë të udhëzuar, mbasi kështu nxjerrim në pah, lidhjet që krijojnë fjalët me njëra tjetrën (Stahl, 1999)¹⁰. Ky lloj veprimi, është veçanërisht i këshillueshëm, në rast se kemi probleme në të mësuar (Juel & Deffes, 2004)¹¹.

Mësimi direkt i fjalëve të veçanta mund të ndikoj pozitivisht, për të fituar një fushë më të gjerë të kuptimit të tyre, të lidhjeve të ndryshme që ato kanë me fjalët e tjera në fjali (anonime, sinonime), të koncepteve e dhe kategorive gramatikore të cilave ju përkasin.

Përmirësimi i leximi është një mënyrë efektive për të arritur suksesin në njohjen e kuptimit të fjalëve. Vlerësimet akademike e kanë mbështetur këtë. Në analizat e hershme në kohë, të studiuesve, u gjet se përmirësimi i leximit, e përshpejtonte atë si proces, në krahasim me përdorimin e metodave të tjera që e synojnë këtë. Programet që janë bazuar te përmirësimi i leximit dhe në teori të ngjashme, kanë qenë të suksesshme (Fountas & Pinnell, 1996, Hiebert, 1994, Taylor, dhe Shearer, 1990)¹², mbasi ato shihen si metoda përqsje orientim-kuptim, që i shërbejnë përmirësimit të aftësisë për të lexuar dhe kuptuar. Përgjithësisht studiuesit i kanë vlerësuar arritjet pozitive në përmirësimin e leximit të tekstit, si shumë efektive. Megjithatë, duhet të përmendim se ka edhe mënyra të tjera që ndikojnë në mënyrë të favorshme për

⁹ C.L.Z. Blachowicz & P. Fisher (2004) *Building vocabulary in remedial settings: Focus on word relatedness*. Perspectives, 30, 1. The International Dyslexia Association.

¹⁰ S.A. Stahl (1999). *Vocabulary development*. Newton Upper Falls, MA: Brookline Books.

¹¹ C. Juel & R. Deffes (2004) *Making words stick*. What Research Says About Reading, 61, 6. Association for Supervision and Curriculum Development: Alexandria, VA.

¹² I. C. Fountas & G. S. Pinnell (1996). *Guided reading: Good first teaching for all children*. Portsmouth, NH: Heinemann.

rritjen e nivelit, nëpërmjet karakteristikave të tjera të leximit, të tilla si vetëdija fonologjike dhe njohuritë drejtshkrimore.

Ato studime që janë mbështetur te përdorimi i një masa të vogël fjalësh, kanë gjetur se përmirësimi në lexim, ndikon pak në përmirësimin e identifikimit të fjalëve. Për shembull, nga hulumtimet, është gjetur se studentët me lexim të përmirësuar, kishin performancë, më të mirë, se sa të tjerët, mbasi masa e përdorimit të fjalëve gjatë leximit ishin më të mëdha. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për masën e vetëdijes së fonemës (shih Askew, Fountas, Lyons, Pinnell, dhe Schmitt, 1998)¹³ edhe pse kur përdoret metoda e përmirësimit të leximit (ku në përgjithësi punohet në kontekstin e leximit dhe shkrimit të lidhur me tekstin), i kushtohet më shumë vëmendje informacionit në nivelin e fjalës dhe nën-fjalës. Në fakt, Adams (1990)¹⁴ ka theksuar se përmirësimi i leximit është si një shembull i kualitetit të mësimit të lartë. Ndërturja e marrëdhënieve të shëndosha të drejtshkrimit me ndërgjegjësimin fonologjik është pjesë integrale e mësimi.

Kujtesa dhe karakteristikat e fjalës

Gjatë viteve, studiuesit kanë hulumtuar shumë për të kuptuar se si njerëzit mund të kujtojnë atë çfarë ata kanë përjetuar në një ngjarje, kohë më parë, nëpërmjet memories së tyre, bazuar në episode të veçanta. Kjo, kërkon ngacmimin e atyre rasteve mbi të cilat është e bazuar njohja e karakteristikave të fjalëve në kujtesë e lidhur me ngjarjen dhe jo në rastet që kanë të bëjnë me një kuptim më të përgjithshëm të tyre. Shumë teori parashtrajnë një rol të veçantë të karakteristikave të fjalëve, në procesin e njohjes së kuptimit të tyre, por shumë pak njihen karakteristikat e veçanta, që mund të çojnë në rritjen e aftësisë së njohjes, sidomos kur bëhet fjalë për njohjen e një fjale të vetme në një listë fjalësh që studiohet.

Studiuesit e kujtesës së njeriut kanë supozuar së kujtesa për një stimul, është në thelb kujtesë për tërësinë e karakteristikave të pavarura, të pranishme në atë stimul. Kjo veçanërisht vlen për teorinë e ndikimit të familjarizimit, për njohjen me termin apo fjalën. Marrim në shqyrtim për shembull, opinionin e përgjithshëm mbi faktorët që ndikojnë në procesin e njohjes (Clark dhe Gronlund)¹⁵. Sipas kësaj përqasjeje, njohja e mirë e kuptimit të fjalës, përcaktohet si një sinjal që del nga një proces, në të cilin karakteristikat e shkëputura të saj, të paraqitura në një tekst të caktuar, arrijnë të përputhen me

¹³ B.J. Askew, I. C. Fountas, C. A. Lyons, G. S. Pinnell & M. C. Schmitt (1998). Reading Recovery review: *Understandings, outcomes, and implications*, Columbus, OH: Reading Recovery Council of North America.

¹⁴ M. J. Adams (1990). *Beginning to read: Thinking and learning about print*. Cambridge, MA: MIT Press.

¹⁵ S. E. Clark & S. D. Gronlund (1996). *Global matching models of recognition memory: How the models match the data*. *Psychonomic Bulletin & Review*, 3, 37-60.

karakteristikat, që janë ruajtur në kujtesë. Sa më e madhe shkalla e përballjes, aq më i fortë do të jetë sinjali i njohjes së mirë të kuptimit të fjalës. Ka një përputhje të përgjithshme më të madhe për tekstet e studiuara, se sa për ato tekste që nuk janë studiuar. Tekstet e studiuara tentojnë të shkaktojnë një sinjal të fortë familjarizimi në krahasim me ata që nuk janë studiuar. Kjo siguron një bazë për dallimin midis dy llojeve të teksteve. Teoritë të cilat mbështeten në përdorimin e përputhjes së karakteristikave të shkëputura të tekstit, me ato që ekzistojnë në kujtesë, parashikojnë efekte të ngjashme në njohje. Duke qenë se përputhja midis karakteristikave të paraqitura në çdo tekst dhe të atyre të pranishme në kujtesë, është e rëndësishme për përjasjen në përgjithësi, por kjo edhe mund të bëjë që te lexuesit, të lindin tendenca të alarmeve të rremë nga tekstet e dhëna, në ngjashmëri me tekstet e studiuara. Në fakt, shumë nga këto përjasje aktuale të njohjes së izoluar nga kujtesa, e përdorin këtë ide për avantazhet e veta.

Një ndikim në raportin midis kujtesës dhe karakteristikave të fjalëve, luan dhe e ashtuquajtura aftësi e përpunimit drejtshkrimor, e cila ndryshon në çdo individ dhe natyrisht që shprehet në mënyra të ndryshme gjatë leximit. Ky koncept është përcaktuar më gjerësisht nga Stanovich & West (1989)¹⁶ si "aftësia për të formuar, mbajtur dhe përafruar përfaqësime drejtshkrimore". Përkufizimet ndryshojnë sipas shprehjes brenda kontekstit të teorisë së rrugës së dyfishtë ose brenda alternativave të përafrimeve.

Konkluzion

Ka një lidhje të dyfishtë midis kuptimit të fjalëve dhe kontekstit. Nga njëra anë njohja e kuptimit të fjalëve na ndihmon që të njohim atë çka përmban dhe thotë konteksti dhe nga ana tjetër vet konteksti na ndihmon të njohim kuptimin e fjalëve të panjohura. Sa më shumë të lexojmë aq më shumë fjalë të panjohura mësojmë, aq më shumë fiksojmë në kujtesë kuptimin e tyre brenda një konteksti të caktuar.

Karakteristikat e veçanta të fjalëve që i referohen një teksti të caktuar dhe ballafaqimi i tyre me ato që janë të ruajtura në kujtesë janë të një rëndësie të veçantë si për njohjen në thellësi të tekstit, po ashtu edhe për njohjen e kuptimit të fjalëve të panjohura. Në këtë artikull janë rradhitur një sërë mjeteve që na ndihmojnë në njohjen e kuptimit të fjalëve. Po kështu, këtij qëllimi i shërben edhe trajtimi i karakteristikave të fjalëve dhe të lidhjeve të tyre me kujtesën.

BIBLIOGRAFI

¹⁶ K.E. Stanovich & R.F. West (1989). *Exposure to print and orthographic processing*, Reading. Research Quarterly 24: 402–433.

Mësimi i kuptimit të fjalës nga konteksti dhe roli i kujtesës fonologjike

- B. J. Askew, I. C. Fountas, C. A. Lyons, G. S. Pinnell & M. C. Schmitt (1998), *Reading Recovery review: Understandings, outcomes, and implications*, Columbus, OH: Reading Recovery Council of North America.
- C. Juel & R. Deffes (2004), *Making words stick*. What Research Says About Reading, 61, 6. Association for Supervision and Curriculum Development: Alexandria, VA
- C. Papagno, T. Valentine & A. Baddeley (1991), *Phonological short-term memory and foreign-language vocabulary learning*. Journal of Memory and Language, 30, 331-347.
- C.L.Z. Blachowicz & P. Fisher (2004), *Building vocabulary in remedial settings: Focus on word relatedness*. Perspectives, 30, 1. The International Dyslexia Association.
- E.D. Hirsch (2003), *Reading comprehension requires knowledge – of words and the world: Scientific insights into the fourth-grade slump and the nation's stagnant comprehension scores*. American Educator, Spring, 2003. American Federation of Teachers.
- I. C. Fountas & G. S. Pinnell (1996), *Guided reading: Good first teaching for all children*. Portsmouth, NH: Heinemann.
- J. Shefelbine (1990), *Student factors related to variability in learning word meanings from context*. Journal of Reading Behavior, 22, 71-97.
- M. Coltheart (1978), *Lexical access in simple reading tasks*. New York: Academic Press.
- M. F. Graves (1986), *Vocabulary learning and instruction*. In E. Z. Rothkopf & L. C. Ehri (Eds.), *Review of research in education* (Vol. 13, pp. 49-89). Washington, DC: American Educational Research Association.
- M. J. Adams (1990), *Beginning to read: Thinking and learning about print*. Cambridge, MA: MIT Press.
- R.C. Anderson & P.D. Pearson (1984), *A schema-theoretic view of basic processes in reading*. In P.D. Pearson, R. Barr, M. L. Kamil, & P. Mosenthal (Eds.), *Handbook of reading research*. New York: Longman.
- S. E. Clark, & S. D. Gronlund (1996), *Global matching models of recognition memory: How the models match the data*. Psychonomic Bulletin & Review, 3, 37-60.
- S. Gathercole & A. Baddeley (1989), *Evaluation of the role of phonological STM in the development of vocabulary in children: A longitudinal study*. Journal of Memory and Language, 28, 200-213.
- S. Gathercole & A. Baddeley (1990), *The role of phonological memory in vocabulary acquisition: A study of young children learning new names*. British Journal of Psychology, 81, 439-454.
- S. Gathercole, C. Willis, H. Emslie & A. Baddeley (1992), *Phonological memory and vocabulary development during the early school years: A longitudinal study*. Developmental Psychology, 28, 887-898.
- S.A. Stahl (1999), *Vocabulary development*. Newton Upper Falls, MA: Brookline Books.

